

Implementimi i Tregut  
Balancues

# MANUAL UDHËZUES PËR PROCESIN “DRY RUN”

TSHB



Operatori i Sistemit të Transmetimit

## PËRMBAJTJA

A.	Përshkrim .....	1
B.	Hyrja ne fazen “Dry Run” .....	2
C.	Detajimi i fazes “Dry Run” .....	3
D.	PROCESI I TREGUT BALANCUES .....	7
	Hapat ne “Dry Run” per operimin e TSHB .....	8
E.	Parimet e shlyerjes (“settlement”) të disbalancave: .....	10
Aneks 1	Testime TSHB .....	11
Aneks 2	PROCESI I NOMINIMEVE TË ENERGJISË .....	12
	1. Procesi i nominimit.....	12
Aneks 3	LLOGARITJA E ÇMIMIT TË DISBALANCËS .....	14
	Përcaktimi i çmimeve të disbalancave.....	14
	Përfundimi i Projektit “Dry Run” .....	16

## A. PËRSHKRIM

Procesi i “Dry Run” ka si objektiv simulimet e tregut që janë të rëndësishme për implementimin e TSHB, ku do të përfshihen simulime si në kushte reale por pa efekte financiare.

Objektivat e kësaj faze janë si më poshtë:


- Pritshmëritë paraprake të operimit te tregut, të çmimeve të pritshme, etj...
- Verifikimi i ngjashmërisë (konsistencës) së proceseve TSHB;
- Verifikimi i përputhshmërisë midis proceseve TSHB dhe jo-TSHB;
- Konfirmimi i mirëfunksionimit operacional të platformes elektronike me anë të së cilës do të bëhet operimi i tregut;
- Trajnimi i pjesëmarrësve të tregut.

Në terma të përgjithshme kjo fazë do ti mundësojë OST-së dhe palëve të interesit per te qënë sa më afër ose të familjarizohen me proceset e pritshme të tregut TSHB.

## B. HYRJA NE FAZEN “DRY RUN”

- a) Procesi parapërgatitor i finalizuar ku presupozohet që rregullat definitive janë konsultuar me palet e interesit dhe janë miratuar paraprakisht nga ERE;
- b) Sistemet IT dhe procedurat operative janë testuar dhe janë gati për operim;
- c) Në rastet e deshtimeve të sistemeve IT mbajtja e proces verbaleve përkatëse ku gjithashtu do shoqërohen dhe me zgjidhje manuale si suport për proceset;
- d) Është siguruar suporti IT për operimin e platformes;
- e) Në rast deshtimi të procesit, përsëritja dhe rifillimi i procesit;
- f) Dry-run do të simulojë “wet-runs”;
- g) Asnjë produkt nga “Dry Run” nuk do të impaktojë në operacionet reale;
- h) Disa rezultate nga operacionet reale mund të përdoren në “Dry Run”;
- i) “Dry Run” duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, të përsërisë të gjitha proceset dhe nënproceset e TSHB me të gjitha palët;
- j) Operimi në “Dry Run” nënkupton që të gjitha informacionet në lidhje me transaksionet e energjisë dhe transaksionet financiare duhet të komunikohen (si në kushte të reale).

### Operimi paralel i sistemeve



### C. DETAJIMI I FAZES "DRY RUN"


- I. Duhet të përcaktohen personat përgjegjës nga pjesëmarrësit e tregut për ndjekjen e projektit dhe komunikimet në "DRY RUN" (kontaktet e tyre);
- II. Personat përgjegjës nga OST që do të jenë në kontakt me pjesëmarrësit e tregut për çdo procedurë gjatë testimeve lista e mëposhtme:

Për problemet IT	Donald Shterpi	<a href="mailto:donald.shterpi@ost.al">donald.shterpi@ost.al</a>	+355688000088
Për problematika ne lidhje me platformen dhe suport teknik:	Ledi Gjini Brisela Mehmetllari	<a href="mailto:ledi.gjini@ost.al">ledi.gjini@ost.al</a> , <a href="mailto:brisola.mehmetllari@ost.al">brisola.mehmetllari@ost.al</a>	+355696394195 +355699230378
Për komunikimin me operimin e sistemit:	Albert Laska, Elio Voshtina	<a href="mailto:albert.laska@ost.al">albert.laska@ost.al</a> ; <a href="mailto:elio.voshtina@ost.al">elio.voshtina@ost.al</a>	+355692049926 +355692673121
Për proceset e parakualifikimit :	Irma Gjordumi, Anida Paci	<a href="mailto:irma.gjordumi@ost.al">irma.gjordumi@ost.al</a> ; <a href="mailto:anida.paci@ost.al">anida.paci@ost.al</a>	+355696040192 +355696043567
Për operimin ne tregun balancues:	Griselda Merkaj Anida Paci	<a href="mailto:griselda.merkaj@ost.al">griselda.merkaj@ost.al</a> <a href="mailto:anida.paci@ost.al">anida.paci@ost.al</a>	+355696010492 +355696043567
Për llogaritjen e disbalancave:	Blerta Mara Arion Hysi	<a href="mailto:blerta.mara@ost.al">blerta.mara@ost.al</a> <a href="mailto:arion.hysi@ost.al">arion.hysi@ost.al</a>	+355695830186 +355694584727
Për skedulimin:	Alban Qurku	<a href="mailto:alban.qurku@ost.al">alban.qurku@ost.al</a>	+355698666680
Për çështje administrative:	Erva Kodra	<a href="mailto:erva.kodra@ost.al">erva.kodra@ost.al</a>	+355698047626


- III. Për të lehtësuar komunikimin me pjesëmarrësit e tregut OST do të vërë në dispozicion një e-mail të dedikuar për këtë projekt, në mënyrë që mos të ketë ripërsëritje të problemit dhe zgjidhjes;
- IV. Përcaktimi i një fashë orare për zhvillimin e procedurës së dedikuar për “DRY RUN” (Pyetje, përgjigje, testime, sqarime, konkluzione) Fasha orare e dedikuar për testime (09:00 – 12:00) zhvillimi i testimeve me një rezolucion 3 ditë pune në javë;
- V. Hyrja në DAMAS mjedisi test (përdoruesit e regjistruar dhe përdoruesit e rinj) update të kredencialeve për secilin user që do të operojë në mjedisin test;
- VI. Njohja me manualin e testimeve nga çdo përdorues i platformës elektronike për t’u kualifikuar si pjesëmarrës në DAMAS;
- VII. Njohja me manualin e përdorimit të modulit të llogaritjeve të disbalancave dhe modulit të balancimit;
- VIII. Regjistrimi i një pjesëmarrësi tregu si PPB (Paraqitja e dokumentacionit sipas bllokskemes së paraqitur);

**PROCESI I REGJISTRIMIT NË "TREGUN BALANCUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE"  
(Tregu Shqiptar i Balancimit)**

**Aplikimi për PPB**




**Nënshkrimi i "Marrëveshjes së Palës Përgjegjëse Balancuese"**



Regjistruar si PPB në Regjistrin e PPB


**Aplikimi për OSHB**



**Nënshkrimi i "Marrëveshjes së Ofruesit të Shërbimit të Balancimit"**



**PARAKULIFIKIMI I NJESIVE GJENERUESE**




Pajisja me "Certifikatën e Parakualifikimit" nga OST sh.a.


Regjistruar si OSHB i kualifikuar

**KOLATERALI** (të paktën 1 vjekar)  
(Garanci Bankare / Depozitë Cash në OST sh.a.)

**PPB me Njohje të plotë**  
(përgjegjës në balancimit në pikat e lidhjes dhe për tregtimet me PPB-të e tjera)



**PPB me Njohje Tregtare**  
(vetëm përgjegjës në balancimit mbi transaksionet me PPB-të e tjera)




Regjistrimi si "PPB/OSHB në Tregun Balancues të Energjisë Elektrike"  
Publikimi në faqen zyrtare të OST sh.a.

**KONFIRMIMI I REGJISTRIMIT**  
Aksesimi në Platformën DAMAS

- IX. Njohja me skenarët e ndërtuar nga OST (me te dhena reale) dhe të dakortësuar me palët, për procedurat që duhet të ndjekë çdo PPB, (deklarimi i transaksioneve, procesi i nominimit, llogaritja e çmimit të disbalancës, llogaritja e disbalancave, faturimi, kërkesat për kolateral) referuar Anekseve të mëposhtme;
- X. Për çdo dite pune testimi do të plotësohet një formular tip (Aneksi 1) i cili do të qarkullohet në fund të ditës së testimeve me pjesëmarrësit duke u dakortësuar nga palët;
- XI. Për çdo deshtim të procedurave të testimit do të hartohet një proces verbal ku do të detajohet problematika dhe do të procedohet me rifillimin e testeve për procedurën e deshtuar;
- XII. Në përfundim të çdo jave testimi do të hartohet një raport në lidhje me outputet e testimeve i cili do të dakortësohet dhe me pjesëmarrësit e tregut;
- XIII. Në fund të çdo muaji do të përgatitet një raport për ERE i dokumentuar për ecurinë e testimeve dhe raportimin në lidhje me pjesëmarrjen në testime.

## D. PROCESI I TREGUT BALANCUES



OST është përgjegjëse për dimensionimin, tenderimin, kontraktimin dhe aktivizimin e shërbimeve balancuese për të ruajtur balancën e sistemit.

OST ka të drejtë të aktivizojë shërbimet balancuese nga OShB-të e kontraktuara deri sa të rivendoset balanca e sistemit. Detyrat e OST gjatë operimit të tregut si më poshtë:

- Masat që duhet të merren nga OST në rast mosbalancimit të sistemit;
- Përgjegjësia e balancës;
- Faturimi dhe shlyerja për BSP;
- Rregullat e nominimit të energjisë, të dhënave të matjeve dhe procesi i shkëmbimit të dhënave;
- Llogaritja e çmimit të disbalancave;
- Kërkesat për kolateral të PPB;
- Faturimi dhe shlyerja për PPB;
- Procesi i përshtatjes të PPB;



## HAPAT NE “DRY RUN” PER OPERIMIN E TSHB

- Procedura e parakualifikimit (njoftimi i gjeneruesve për të kaluar në testet parakualifikuese, zhvillimi i testeve dhe kualifikimi nga OST të gjithë gjeneruesve që plotësojnë kriteret teknike si BSP, marveshja e lidhur me OST si OSHB);
- Procedura e tenderit për prokurimin e kapacitetit rezerve (procedurë javore);
- Procedura tenderit për prokurimin e energjisë balancuese;
- Faturimi për rezervën dhe energjinë balancuese. (procedure javore)

Shërbimi i balancimit do të prokurohet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese duke zbatuar procedurën e prokurimit përmes tenderit publik të bërë në mënyrë periodike (konform skenarëve të përgatitur dhe të percjella një ditë para ditës së testimit të pjesëmarrësit) me kërkesat e mëposhtme të paracaktuara:

- Identifikimin, parametrat teknikë dhe financiarë të një produkti balancues;
- Periudha për të cilën bëhet oferta - brenda ditës (në vazhdim, bllok kohe një orë ose bllok kohe në orë të veçanta);
- Metoda e dorëzimit të ofertës;
- Koha e Dorëzimit të ofertës, specifikimi i ofertës - oferta mund të jetë e ndare ose e pandashme;
- Metoda e përzgjedhjes së ofertës;
- Sasia e kërkuar e rezervës së energjisë;
- Ofertat e energjisë balancuese, ofertuesit do të ofrojnë çmim balancues të energjisë në Euro / MWh;
- Operatori i sistemit të transmetimit, në përputhje me metodën e përzgjedhjes së ofertës, krahasimin e sasive të kërkuara dhe të ofruara dhe çmimet e furnizimit të energjisë rezervë, krijon një listë të sipas meritës (“Merit Order”) duke filluar nga oferta më e ulët;
- Pas përfundimit të procedurës së tenderit, operatori i sistemit të transmetimit do të njoftojë të gjithë ofertuesit për rezultatet e tenderit, duke i percjellë me e-mail;
- Ofruesit e shërbimeve balancuese, ofertat e të cilëve është pranuar duhet të paraqesin ofertat e energjisë balancuese tek operatori i sistemit të transmetimit për sasinë e energjisë rezervë nga procedura përkatëse e tenderimit.


Parimet e shlyerjes (“settlementit”) së energjisë balancuese do të jenë si më poshtë:

- Shlyerja do të percaktohet veçmas për secilin interval kohor dhe veçmas për secilin drejtim;
- Energjia balancuese do të llogaritet për energjinë e lëvruar;
- Shlyerja bazohet në sasi të percaktuara nga urdhri i aktivizimit të energjisë balancuese dhe çmimet e njësisë nga ofertat e dërguara nga ofruesit e energjisë.


Metoda e shlyerjes (“settlementit”) së energjisë balancuese përcaktohet me:

- Marrëveshjen për blerjen dhe shitjen e energjisë balancuese, Marrëveshje me operatorët e tjerë të sistemit të transmetimit.

## Ofertat + Përzgjedhja + Proçesi i çmimit



# Proçesi i aktivizimit : aFRR, mFRR



## E. PARIMET E SHLYERJES ("SETTLEMENTIT") TË DISBALANCAVE:

- OST do të përcaktojë një llogari fillestare të Disbalancave të PPB për çdo 15 minuta, në perfundim të ditës së testimit.  
Pasi OST të ketë mbledhur të gjitha nominimet e miratuara për tërheqje dhe injektim për çdo pikë lidhje, për transaksionet e brendshme me PPB të tjera dhe për transaksionet ndër-zonale për çdo kufi zone.
- Shlyerja ("settlement"-i) i disbalancave do t'u dërgohet me bazë javore çdo PPB-je pas verifikimeve përkatëse me të dhënat e matjeve për ditët respektive të testeve.
- Konfirmimi i të dhënave të dërguara të shlyerjes (settlementit) të disbalancave nga ana e PPB-së përkatëse, do të presupozoj arrijtjen me sukses të proçesit dhe përgatitjen e mëtejshme të Faturës Tatimore (gjate "Dry Run" konfirmimi i proformes merr të mireqene gjenerimin e fatures tatimore).

**ANEKS 1 TESTIME TSHB**

**Data**

**Ora**

**Subjekti Pjesmarrës** .....

**në Testim**

**Skenari i Testit** .....

**Rezultate**

**Pati problematika:**     Po             Jo

**Nëse po, çfarë problematike?**

.....

**Zgjidhja e duhur?**

.....

**Veprimet që u ndërморën:**

.....

.....

.....

**Personi përgjegjës**

.....

.....

.....

**Afati**

**XX/ZZ/YYYY**

**XX/ZZ/YYYY**

**XX/ZZ/YYYY**

**PËRFUNDIME**

**U mbyll problematika:**     Po             Jo

.....

**Rekomandime:**

.....


**Shënime të mëtejshme:**

.....

## ANEKS 2 PROCESI I NOMINIMEVE TË ENERGIJË

### 1. PROCESI I NOMINIMIT

Në procesin “Dry Run” procesi i nominimeve dhe i testimeve do të kryhet në fashën orare 09:00 – 12:00:



- Të gjitha PPB-të janë të detyruara të dërgojnë nominimin e tyre te OST para mbylljes së portës. Nominimi përfshin të gjitha tregtimet ndër-zonale dhe brenda-zonale si dhe shkëmbimin brenda rrjetit për çdo PShD të ditës së transaksionit.
- Informacioni i detajuar i kërkuar specifikohet nga OST.
- PPB duhet të ndjekë procesin e nominimit dhe mbylljen e portës përkatëse, të cilat përcaktohen nga OST.
- OST duhet të kontrollojë nominimet e PPB-ve sa i përket konsistencës së tyre. Nëse jepet konsistenca e nominimit, PPB do të marrë një miratim nga OST për nominimet e saj.
- PPB do të përdorë *file-n* standart të nominimeve të paracaktuar nga OST. Paraqitja e tij do të bëhet përmes platformës online të dedikuar që do të instalohet nga OST dhe, në rastet e padisponueshmerisë së platformës, me e-mail si një zgjidhje rezervë.
- Për çdo nominim në çdo drejtim duhet të jenë në rezolucionin kohor 15 minutesh.
- Me pas kontrollohet vlefshmëria e nominimeve të dërguara nga PPB tek OST dhe çdo korigjimi të mundshëm.

- Nëse një PPB nominon një transaksion me një PPB tjetër, dhe PPB-ja tjetër nuk nominon të njëjtin vëllim të transaksionit në drejtimin tjetër, nominimi i jashtëm është i pasaktë. Në këtë rast, vëllimi më i ulët i nominuar do t'u imponohet të dy PPB-ve. Një përjashtim është kur PPB tjetër është ALPEX. Në këtë rast, nominimi i transaksionit i ALPEX prevalon.

-Të gjitha nominimet nga PPB duhet të jenë në pozicion neto zero. Para kohës së mbylljes së portës ndër-zonale të Tregut Brenda Ditës, çdo PPB mund të ndryshojë skedulet, të nevojshme për të llogaritur pozicionin e saj. PPB do të veprojë sipas nominimit për të shmangur disbalancat, që janë diferenca mes shkëmbimeve të nominuara dhe të realizuara në rrjet.

## ANEKS 3 LLOGARITJA E ÇMIMIT TË DISBALANCËS

### PËRCAKTIMI I ÇMIMEVE TË DISBALANCAVE

Përkufizime:

- Rregullimi në rritje
- Rregullimi në ulje
- Çmimi për energjinë balancuese në rritje
- Çmimi për energjinë balancuese në ulje
- Komponentja nxitëse (Vlera fillestare në “Dry Run” do të jete zero)
- Delta e balancës: Proxy për disbalancat e sistemit për t’u bërë të njohura në kohë reale nga OST (open loop ACE): *“Disbalancat llogariten nga OST për çdo periudhë llogaritëse, për çdo palë përgjegjëse të balancimit. Përlllogaritja e disbalancave të PPB-ve bëhet në përputhje me specifikimin e gjendjeve të rregullimit apo ‘Delta e balancës’ që është një shifer perfaqesuese (proxy) për disbalancat e sistemit të llogaritura për rregullimin në qark të hapur (open loop ACE)*
- Gjendja e balancës së sistemit përcaktohet nga balanca neto e sistemit gjatë periudhës përkatëse: me mungesë ose me tepriçë.
- Nëse balanca neto e sistemit është me mungesë, çmimi i disbalancës i referohet çmimit mesatar të paguar për ofertat e balancimit të aktivizuara për rritje (ÇMrr)
- Nëse balanca neto e sistemit është me tepriçë, çmimi i disbalancës i referohet çmimit mesatar të paguar për ofertat e balancimit të aktivizuara për ulje (ÇMu)
- PPB-të paguan çmimin e disbalancës në rast mungese dhe paguhen për çmimin e disbalancës në rast tepriçë.

	Sistemi ka mungesë	Sistemi ka tepriçë
PPB paguan për mungesën	$\geq \text{ÇMrr}^*(1+\text{Komponente Nxitëse})$	$\leq \text{ÇMu}^*(1+\text{Komponente Nxitëse})$
PPB paguhet për tepriçën	$\geq \text{ÇMrr}^*(1-\text{Komponente Nxitëse})$	$\leq \text{ÇMu}^*(1-\text{Komponente Nxitëse})$

- Çmimi i Disbalancës në Proformë (ÇDP) është i përcaktuar nga Mekanizmi Balancues, i bazuar në Rregullimin Sekondar të angazhuar, në Rregullimin Terciar të angazhuar si dhe Rezervat kontraktuale të angazhuara.

- Çmimi i Disbalancës në Proformë është i përcaktuar nga formula më poshtë:

$$\text{ÇDP (ISP)} = \frac{RrTA \times \text{ÇRT} + RrSA \times \text{ÇRS} + RK \times \text{ÇRK}}{RrTA + RrSA + RK}$$

- Ku:
  - RrTA - Total Rregullimi Terciar i angazhuar
  - RrSA - Total Rregullimi Sekondar i angazhuar
  - RK - Total Rezerva kontraktuale e angazhuar
  - ÇRT - Çmimi i ponderuar për Rregullimin Terciar
  - ÇRS - Çmimi për Rregullimin Sekondar
  - ÇRK - Çmimi për Rezervën kontraktuale të angazhuar
- Shenja përpara Energjisë Balancuese varet nga drejtimi i angazhimit:
  - (“+” për Rregullimin në “Rritje” dhe “-” për Rregullimin në “Ulje”)

Në përfundim të çdo jave testimi do të shihet rezultati financiar, si rrjedhojë e llogaritjeve për të ardhurat dhe detyrimet për shërbimin e balancimit, ky rezultat financiar do u behet i njohur dhe pjesëmarrësve të tregut në raportin javor.

Në vijim të këtij rezultati financiar OST së bashku me pjesëmarrësit e tregut do të kenë më të qartë vlerën që duhet të ketë komponentja nxitëse për të rezultuar efektive.



Skenari përgatitjes së Proformës së Disbalancave të “Palës Përgjegjëse Balancuese” i cili do të përdoret gjatë “Dry Run” :

PPB 1		Te dhenat e skeduluara				Te dhenat e Balancimit			Te dhenat e Matjeve				Proforma e PPB			
Data	Ora	Kufi Skedulimet e Brendshme				Rregullimi ne Rritje [MWh]	Rregullimi ne Ulje [MWh]	Pozicioni Neto i Nominuar [MWh]	Njesite e Kontrollueshme		Skeduli i Gjenerimit te Njesive e Kontrollueshme [MWh]	Pozicioni Neto i Matur [MWh]	Disbalanca e PPB [MWh]	Çmimi ne Rritje	Çmimi ne Ulje	Pagesa [€]
		Eksport [MWh]	Import [MWh]	Eksport [MWh]	Import [MWh]				Prodhimi [MWh]	Konsumi [MWh]						
	00:00 - 00:15	5	3	90	0	3.00	0.00	95.00	111	0	0	111	16.00			0.00
	00:15 - 00:30	5	3	90	0	3.00	0.00	95.00	111	0	0	111	16.00			0.00
	00:30 - 00:45	5	2	90	0	3.00	0.00	96.00	111	0	0	111	15.00			0.00
	00:45 - 01:00	5	2	90	0	2.00	0.00	95.00	111	0	0	111	16.00			0.00
	01:00 - 01:15	5	5	90	0	3.00	2.00	91.00	107	0	0	107	16.00			0.00
	01:15 - 01:30	5	5	90	0	3.00	1.00	92.00	107	0	0	107	15.00			0.00
	01:30 - 01:45	5	5	90	0	2.00	1.00	91.00	107	0	0	107	16.00			0.00
	01:45 - 02:00	5	5	90	0	2.00	1.00	91.00	104	0	0	104	13.00			0.00
	02:00 - 02:15	5	7	90	0	3.00	0.00	91.00	103	0	0	103	12.00			0.00
	02:15 - 02:30	5	6	90	0	3.00	0.00	92.00	103	0	0	103	11.00			0.00
	02:30 - 02:45	5	6	90	0	3.00	0.00	92.00	103	0	0	103	11.00			0.00
	02:45 - 03:00	5	6	90	0	2.00	0.00	91.00	102	0	0	102	11.00			0.00
	03:00 - 03:15	5	4	90	0	4.00	1.00	94.00	90	0	0	90	-4.00			0.00
	03:15 - 03:30	5	4	90	0	3.00	1.00	93.00	90	0	0	90	-3.00			0.00
	03:30 - 03:45	5	4	90	0	3.00	1.00	93.00	90	0	0	90	-3.00			0.00
	03:45 - 04:00	5	3	90	0	3.00	1.00	94.00	89	0	0	89	-5.00			0.00

PPB 2 (Konsumator)		5				Te dhenat e Balancimit			Te dhenat e Matjeve				Proforma e PPB			
Data	Ora	Kufi Skedulimet e Brendshme				Rregullimi ne Rritje [MWh]	Rregullimi ne Ulje [MWh]	Pozicioni Neto i Nominuar [MWh]	Njesite e Kontrollueshme		Skeduli i Gjenerimit te Njesive e Kontrollueshme [MWh]	Pozicioni Neto i Matur [MWh]	Disbalanca e PPB [MWh]	Çmimi ne Rritje	Çmimi ne Ulje	Pagesa [€]
		Eksport [MWh]	Import [MWh]	Eksport [MWh]	Import [MWh]				Prodhimi [MWh]	Konsumi [MWh]						
	00:00 - 00:15	0	0	0	23	0	0	-23.00	0	0	-90	-310	-287.00			0.00
	00:15 - 00:30	0	0	0	23	0	0	-23.00	0	0	-90	90	113.00			0.00
	00:30 - 00:45	0	0	0	22	0	0	-22.00	0	0	-90	90	112.00			0.00
	00:45 - 01:00	0	0	0	22	0	0	-22.00	0	0	-90	90	112.00			0.00
	01:00 - 01:15	0	0	0	23	0	0	-23.00	0	0	-90	-270	-247.00			0.00
	01:15 - 01:30	0	0	0	23	0	0	-23.00	0	0	-90	90	113.00			0.00
	01:30 - 01:45	0	0	0	22	0	0	-22.00	0	0	-90	90	112.00			0.00
	01:45 - 02:00	0	0	0	22	0	0	-22.00	0	0	-90	90	112.00			0.00
	02:00 - 02:15	0	0	0	23	0	0	-23.00	0	0	-90	-210	-187.00			0.00
	02:15 - 02:30	0	0	0	23	0	0	-23.00	0	0	-90	90	113.00			0.00
	02:30 - 02:45	0	0	0	22	0	0	-22.00	0	0	-90	90	112.00			0.00
	02:45 - 03:00	0	0	0	22	0	0	-22.00	0	0	-90	90	112.00			0.00
	03:00 - 03:15	0	0	0	23	0	0	-23.00	0	0	-90	-260	-237.00			0.00
	03:15 - 03:30	0	0	0	23	0	0	-23.00	0	0	-90	90	113.00			0.00
	03:30 - 03:45	0	0	0	22	0	0	-22.00	0	0	-90	90	112.00			0.00
	03:45 - 04:00	0	0	0	22	0	0	-22.00	0	0	-90	90	112.00			0.00

## PËRFUNDIMI I PROJEKTIT “DRY RUN”

Procesi “Dry Run” quhet i përfunduar në momentin kur stafi i OST dhe pjesëmarrësit e tregut janë familjarizuar me proceset e përfshira në rregulla dhe është arritur në konkluzione të qarta teknike dhe financiare.

Në këtë kuadër, për të kaluar në fazën “Go Live” të projektit do ndiqen hapat e mëposhtëm:

- Hartimi i një raporti final për gjithë problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të kësaj faze si dhe sygjerime për përmirësime të mundshme në Rregullat e Tregut Balancues;
- Workshop final për rezultatet e “Dry Run”;
- Propozimi në ERE përsa më sipër për adresimin korrekt të problematikave dhe përmirësimeve rezultuar nga ky projekt.